# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-435380**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbrojtja e Thaçit kërkon lirimin e tij: Vendimi duhet të bazohet në prova, jo në spekulime |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/rajoni/mbrojtja-e-thacitkerkon-lirimin-etij-vendimi-duhette-bazohet-neprova-jo-n-i585231` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 16:13:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 16:55:13 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `b64b1d5f05580c459358e341bfdcc2480bedd2538d1eed3dd0603e6bb974c0c9` |
| TEKSTI | `d44260b2668c02065dd7f6a8e92a4e7860c6e76e641e275eda966b543d83bcd6` |
| PAMJA | `4a8a64ef5fddee84394ef178ace9fa3e7a2bf52ae2814af12f9d87fe758be6a4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d065c0489f9fd59e4e3717e7aaaaad3969b3feb2d004db1ed5774d2aa2d1c913` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d065c0489f9fd59e4e3717e7aaaaad3969b3feb2d004db1ed5774d2aa2d1c913`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Mbrojtja e Thaçit kërkon lirimin e tij: Vendimi duhet të bazohet në prova, jo në spekulime

10 Shtator 2026, 18:55Rajoni TEMA

Mbrojtja e Thaçit kërkon lirimin e tij: Vendimi

Mbrojtja e Hashim Thaçit e përfaqësuar nga avokatja, Sophie Menegon ka thënë që vendimi i trupit gjykues ndaj klientit të saj duhet të bazohet në prova dhe rrjedhimisht ai të lirohet.

Sipas saj, vendimi nuk duhet të mbështetët në spekulimet e Prokurorisë.

“Prokuroria iu kërkon juve që të dërgoni në burg z. Thaçi për 6 vjet për biseda që janë bërë në qendrën e paraburgimit të cilat nuk kanë pasur asnjë ndikim në botën reale. Ne kërkojmë që vendimi i juaj që të bazohet në prova dhe jo në spekulime edhe që të jetë lirimi nga të gjitha akuzat”, tha Menegon.

Përveç kësaj, Menegon tha se dëshmitarët që janë përmendur në aktakuzën ndaj Thaçit dhe të tjerëve kanë pohuar se nuk janë ndikuar nga askush.

“Dëshmitarët e përmendur në aktakuzë siç është Mustafa, Bislim Zyrapi apo dëshmitari 4 kur janë marrë në pyetje nga ZPS-ja kanë pohuar se nuk ka ndërhyrë askush tek ata. Edhe në qoftë se një pjesë e informacionit pretendohet se është përmendur nga Thaçi gjatë vizitave ishte i klasifikuar si konfidencial në çështjen 6 në praktik, pjesa më e madhe e tij ishte në fushën publike apo që njihej nga vizitorët e Thaçit”, tha Menegon.

Rrjedhimisht, Menegon tha se në praktikë nuk ka asnjë viktimë në këtë çështje.

“Në praktikë nuk ka asnjë viktimë në këtë çështje”, tha ajo.

Menegon tha se Thaçi akuzohet për tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes veprimeve të përbashkëta në një grup. Sipas saj, krimet e pretenduara nuk ndiqen pothuajse kurrë penalisht në Kosovë.

“ZPS-ja e bën këtë për të justifikuar masat tejet ndërhyrëse që janë marrë ndaj Thaçi për muaj të tërë. Incizimet e bisedave të tij, bisedave telefonike, bisedat e privilegjuara përfshirë edhe ato me bashkëshorten dhe djalin e tij”, tha ajo.

Menegon shtoi se provat e prokurorisë janë të dobëta nga ana ligjore dhe ajo faktike.

Avokatja tha se Prokuroria nuk ka prova për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

“ZPS-ja pretendon se janë dëmtuar provat… Mirëpo, meqë nuk kanë prova për një gjë të tillë, ZPS-ja pretendon dhe jep një imazh të pavërtetë të ndërhyrjes së dëshmitarëve me forcë. Pra, është e qartë që ZPS-ja ka shtrembëruar kuptimin e nenit 401 i cili nuk ka lidhje fare me pretendimet që ka ngritur ZPS-ja në këtë çështja gjyqësore apo me interesat që ZPS-ja po pretendon se po mbron”, tha ajo.

Menegon tha se Thaçi akuzohet edhe me shkeljen e fshehtësisë së procesit sipas nenit 392 të KPK-së.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Gjyqi ndaj Thaçit për pengim të drejtësisë hyn në fazën përfundimtare, sot nisin deklaratat në Hagë

09:25 Rajoni / 9 komente

A mundet Haxhiu ta ushtrojë detyrën e presidentit edhe për gjashtë muaj të tjerë?

09:15 Rajoni / 1 koment

Lidhjet mes politikës, klubeve dhe tifozëve: Madhërimi i Mlladiçit pa reagime dhe sanksione

08:55 Rajoni

Drogë mes trëndafilave, kapen 100 kg kokainë në aeroportin e Athinës! Mes 6 të arrestuarve edhe 4 shqiptarë

08:25 Rajoni / 3 komente

Ish-deputeti i Vetëvendosjes kallëzon penalisht Albin Kurtin, e akuzon për shpërdorim detyre dhe bllokimin e institucioneve

21:00 Rajoni / 17 komente

Ish-ambasadori i SHBA-së: Strategjia perëndimore për të "rregulluar" Serbinë ka dështuar

14:20 Rajoni / 10 komente

Kurti: Konstituimi i Kuvendit dhe formimi i qeverisë nuk shmangin zgjedhjet e reja, nevojiten vota shtesë për Presidentin!

13:34 Rajoni / 11 komente

Profesori serb pas varrimit të Mlladiçit: Popull gjenocidal, përqafuam gjenocidin ndaj boshnjakëve

13:20 Rajoni / 12 komente

Vuçiç shpërndan Parlamentin në Serbi, shpall zgjedhje të parakohshme

13:10 Rajoni

Kosovë/ Albulena Haxhiu zgjidhet kryetare e Kuvendit

11:41 Rajoni / 7 komente

**Më të lexuarat**

## Më të lexuarat

### 24 oret e fundit

### Javen e fundit

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 15 komente

**VIDEO/ Protestuesit nuk kursejnë as qytetarët, sulmojnë n...**

21:12 Politika / 80 komente

**Koinçidenca misterioze e 12 shtatorit, ‘Flamingot’ përpla...**

19:20 Blog / 25 komente

**VIDEO/ Thellohet përçarja mes protestuesve, protesta ndah...**

20:20 Politika / 36 komente

**Përçarja në protestë, Balla i përshëndet nga Paskuqani pa...**

22:10 Politika / 3 komente

## Blog Tema

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog

**Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet**

12:38 Blog / 13 komente

**Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?**

10:25 Blog / 21 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.